




MASTERPLANI I QYTETIT STUDENTI

STUDIO ÇOMI

TIRANË 2015





STUDIO ÇOMI

ark. EDI ÇOMI

ark. ELTON ÇOMI

ark. RUDINA PAPAVASILI

ark. ORLEN RAMZOTI

ing. ENTON KRISTO

konsulence per konstruksionin dhe rinovimin

urb. GJERGJ PAPAVASILI

konsulence per planifikimin urban

ARBEN THEODHOSI



konsulence per hapsirat e lira dhe te gjelberta

VLADIMIR GJURGJAJ

Konsulence per infrastrukturen

PETRIT HOXHAI

Konsulencia per energji dhe ambientin



VENDNDODHJA

QS ESHTË PJESË PËRBERESE E TIRANËS DHE NDODHET NE JUG-LINDJE, NE NJË NGA PJESËT ME TE BUKURA TE QYTETIT, PRANE PARKUT TE MADH TE LIQENIT QE ESHTË POTHUAJSE PJESË E TIJ, DHE NE DISTANCE KEMBESORE 5 -15 MIN NGA SHESHI NENE TEREZA, KORPUSI QENDROR I UT, AKADEMIJA E ARTEVE DHE BULEVARDIT KRYESOR TE QYTETIT.

RRUGA E ELBASANIT QE KALON PERGJATE KUFIRIT JUG PERENDIMOR LEJON NJË MUNDËSI TE MIRE AKSESI PER NE KAMPUS E CILA PER FAT TE KEQ ESHTË EDHE E VETMJA, PASI NGA TE TRE ANËT E TJERA TERRITORI I QS ESHTË I KUFIZUAR NGA HAPSIRA TE DENDURA BANIMI PJESËRISHT INFORMALE DHE NJË "SISTEM" KAOTIK INEFICIENT RRUGOR.




KJO PËRBEN EDHE NJË NGA KUFIZIMET SERIOZE URBANE TE KETIJ TERRITORI.

GJEOGRAFIA – TOPOGRAFIA

QYTETI STUDENTI SHTRIHET NE NJE SIPERFAQE RRETH 25 HA DUKE U POZICIONUAR NE MENYRE IDEALE NE FAQEN E NJE KODRE ME PJERESI NATYRALE 8-10% ME NJE EKSPOZIM TE GJERE PERBALLE JUGUT DUKE PERFITUAR DRITE NATYRALE DHE DIELL TE PANDERPRERE GJATE GJITHE DITES.

PAMJA E PANDERPRERE E KUROS SE GJELBERT TE PARKUT TE LIQENIT ESHTË NJE TJETER AVANTAZH I KETIJ POZICIONI.


KETO KARAKTERISTIKA UNIKE PERBEJNE ELEMENTIN BAZE NGA I CILI FILLON KONCEPTIMI I STRUKTURES FIZIKE TE MASTER PLANIT DHE GJITHASHTU PERCAKTOJNE KRITERET BAZE TE ZHVILLIMIT HAPSINOR TE KAMPUSIT.






GJENDJA EKZISTUESE

QYTETI STUDENTI ESHTË KONCEPTUAR NE FILLIMET E VETA KREJTESISHT SI NJE QENDER RESIDENCIALE PER STUDENTET E UT DHE PERBEHEJ KRYESISHT NGA REZIDENCA STUDENTORE - KONVIKTE DHE HAPSIRAT NDIHMESE, ZYRA ADMINISTRATE, TERRENE SPORTIVE DHE NJE KINOTEATER. SOT NDODHET NE NJE GJENDJE TE SHPERBERE DHE KAOTIKE, NE NEVOJE TE DESHPERUAR PER NJE RIKONCEPTIM TE PLOTE HAPSINOR DHE PROGRAMOR.





AKSESI

AKSESI KRYESOR PER NE QYTETIN STUDENTI, EDHE NE PROPOZIMIN TONE MBETET AI EKZISTUES, SI E VETMJA MUNDESI. NE PROPOZIMIN TONE KY DEPERTIM ZGJATET DERI NE EKSTREMIN VERIOR TE TERRITORIT, DHE GJITHASHTU NE PROPOZOJME NJE DEPERTIM TE DYTE JUG-VERI, PARALEL ME TE PARIN, DUKE KRIJUAR NJE UNAZE TE BRENDESHME TE MBYLLUR, DHE DUKE SHPETUAR TERRITORIN E KAMPUSIT NGA QARKULLIMI I MAKINA NE

BRENDESI TE TIJ. KESHTU KRIJOHET NJE SISTEM RRUGOR, I NGJASHEM ME ATE ORTOGONAL DHE PER PASOJE FORMOHEN ZONA DHE BLOQE LEHTESISHT TE AKSESUESHME. KJO STRUKTURE QARKULLIMI KRIJON ZONA TE DEFINUARA QARTE PER NGA FUNKSIONI DHE MUNDESITE E ZHVILLIMIT TE METEJSHEM. NJE NGA PRINCIPET E ZHVILLIMIT TE KESAJ SKEME KA QENE KRIJIMI DHE MBAJTJA HAPUR E KORRIDOREVE JUG – VERI, PER TE LEJUAR NJE VENTILIM MAKSIMAL NATYRAL DHE EKSPozIM MAKSIMAL KUNDREJT DITES DHE DIELLIT.



KEY CONCEPTUAL POINTS

THE MASTER PLAN ACCOMMODATES PRESENT DAY PROGRAMMATIC NEEDS FOR UNIVERSITY TEACHING AND RESEARCH FACILITIES, UNIVERSITY LIBRARIES AS WELL AS CULTURAL RECREATION AND SPORT EVENTS. TRYING TO REVERSE THE CURRENT STATE OF PRIMARILY HOUSING AND STUDENT RESIDENCES.

REFUSING THE CURRENT CHAOS OF THE SUBURBAN INFORMAL HOUSING DEVELOPMENT THAT SURROUNDS THE SITE WE LOOK FOR AN ORDER SPECIFIC TO THE OPEN ZONES AT THE EDGE OF THE CITY.


TWO PROTOTYPICAL STRATEGIES ARE PROPOSED:

1. A DIVISION OF THE SITE IN ZONES AND CLUSTERS OF BUILDINGS BLOCKS THAT RECOGNIZES THE PRESENCE OF NATURE AND MAINTAINS OPEN GREEN SPACE
2. A CONTINUOUS ARCHITECTURAL INFRASTRUCTURE THAT WILL ALLOW FLEXIBLE DEVELOPMENT TO ACCOMMODATE GROWTH AND CHANGE.

A PLACE BETWEEN THE CITY AND THE LANDSCAPE: SPACES FOR LEARNING AND RECREATION.

THE MASTER PLAN EXAMINES CAMPUS HOUSING AND LEARNING ENVIRONMENT THE SPATIAL ORGANIZATION AND FUNCTION OF THE BUILT ENVIRONMENT LANDSCAPE AND OPEN SPACE, CIRCULATION AND PARKING COMMUNITY CONNECTIONS AND OVERALL CONDITIONS OF THE CAMPUS WITHIN THE CONTEXT OF A COMPREHENSIVE PLAN. IT PROVIDES A VISION FOR STUDENT LIFE WITH AN EMPHASIS ON LEARNING, ART AND RECREATION SPACES WHICH LIES AT THE HEART OF THE CAMPUS

PROPOZIMI JONE FOKUSOHET NE KRIJIMIN E NJE HAPSIRE KOMPLEKSE TE INTEGRUAR NE STRUKTUREN EKZISTUESE TE QYTETIT STUDENTI POR NE TE NJEJTEN KOHE TE HAPUR DREJT QYTETIT DUKE OFRUAR OPORTUNITETE QE ATIJ I MUNGOJNE. KJO HAPSIRE PERMBAN BIBLIOTEKEN UNIVERSITARE, MEDIATEKE, NJE AUDITOR ME 450 VENDE PER LEKSIONE, KONCERTE ETJ. DHE AMBJENTE TE TJERA PER ART, REKREACION DHE EVENTE



NDERTESAT E PROPOZUARA

NDERTIMET E REJA NE MASTERPLAN JANE TE PROPOZUARA KRYESISHT JANE PERQENDRUAR NE PJESEN QENDRORE JUGORE TE TERRITORIT, NE PIKEN ME TE AFERT ME AKSESIN KRYESOR ME RRUGEN E ELBASANIT, GJE QE BEN NJE AVANTAZH PER QYTETIN E TIRANES.


KONKRETISHT PROPOZOHEN DY NDERTESA 4 KATESHE MESIMDHENIE, TE CILAT JANE TE POZICIONUARA NE HYRJE, PRANE GODINES EKZISTUESE TE EKONOMIKUT.

GJITHASHTU NJE OBJEKT I RENDESISHEM I PROPOZUAR ESHTJE BIBLIOTEKA UNIVERSITARE, ME SALLA LEKSIONESH DHE STUDIMI, SI DHE AMBIENTE TE TJERA NDIHMESE, SI DHE NJE AUDITOR ME KAPACITET PREJ 450 VENDE, I CILI QENDRON SI VOLUM I SHKEPUTUR DHE I AKSESUESHEM NGA DISA PIKA.

TRE NDERTESA TE REJA QE DO TE SHERBEJNE SI REZIDENCA STUDENTORE, KU ME E SPIKATURA ESHTJE NDERTESA QE ZHVILLOHET NE FORME LINEARE MBI NDERTESEN E BIBLIOTEKES, POR E SHKEPUTUR VERTIKALISHT .

GJITHASHTU JANE PARASHIKUAR EDHE HAPSIRA TE TJERA PER AKTIVITETE ARTI DHE REKREACIONI, SI DHE TERRENE SPORTIVE.





NDERTESAT EKZISTUESE TE RINOVUARA

NDERTESAT EKZISTUESE JANE NE NJE NEVOJE TE DESHPERUAR PER NJE RINOVIM TE THELLE. SI PASOJE NE PROPOZOJME NXJERRJEN E TYRE NE STRUKTUREN BAZE NE MURATURE TULLE DHE SOLETA BETON-ARME, DHE RIBERJEN E GJITHE RRJETIT ELEKTRIK, FURNIZIM ME UJE DHE SHKARKIME, SI DHE GJITHE FINITURAT E BRENDESHME MBI BAZEN E NJE RIKONCEPTIMI TE PLANIMTRISE TIP.

KONKRETISHT PROPOZOJME DHOMA TEKE ME SIPERFAQE TEPER RACIONALE DHE JO ME PAK SE NJE BANJO PER DY DHOMA.

NJE PIKE TEPER E RENDESISHME E RINOVIMIT ESHTJE EDHE APLIKIMI I TEKNOLOGJIVE PER NJE KONSUM SA ME TE ULET ENERGJITIK.

KONKRETISHT PROPOZOJME TERMOIZOLIM TE JASHEM TE PANDERPRERE, JO ME PAK SE 5 CM, DRITARE ME PANELE DOPIO-XHAM DHE STRUKTURE ME NDERPRERJE TERMIKE DHE BRISOLE TE DETYRUARA PER FASADAT JUGORE DHE PERENDIMORE, MASA KETO TE CILAT DO TE REZULTOJNE NE ULJEN MBI 50 % TE KONSUMIT TE ENERGJISE.

GJURMA E NDERTIMIT FOOTPRINT AREA	NDERTIM TOTAL TOTAL BUILD AREA
--------------------------------------	-----------------------------------

NDËRTESA EKZISTUESE EXISTING BUILDINGS	m² 33 000	m² 19 350
MËSIMDHËNIE TEACHING, RESEARCH	6 900	20 900
REZIDENCA RESIDENTIAL	19 800	85 850
ADMINISTRATE, SHERBIME, TEKNIKE ADMINISTRATIVE, SERVICE, TECHNICAL FACILITIES	6 300	12 600
NDËRTESA TË PROPOZUARA PROPOSED BUILDINGS	24 400	43 100
BIBLIOTEKA UNIVERSITARE, AUDITORI, AKTIVITETE U-LIBRARY, ART, INDOOR SPORT, CULTURAL FACILITIES	16 600	22 700
REZIDENCA RESIDENTIAL	4 600	11 800
MËSIMDHËNIE TEACHING, RESEARCH	3 200	8 600
NDËRTESA TOTAL TOTAL	57 400	162 450

SIPËRFAQE E ZONËS QË MERRET NË STUDIM**26.2 Ha**

SIPËRFAQE E ZONËS KAMPUS - CAMPUS PROPOSED AREA

22.4 Ha

SIPËRFAQE E LIRE & GJELBËRIM - OPEN SPACE & GREEN AREA

12 Ha

ZONE JASHTË FUNKSIONIT TE KAMPUSIT - NOT IN CAMPUS FUNCTION

1.6 Ha

SIPËRFAQE TOTALE NDERTIMI M²
CMIMI I PARASHIKUAR PER M² (EURO)**NDERTIMET EKZISTUESE TE RINOVUARA**


19,350

250 - 300

NDERTIMET E PROPOZUARASIPËRFAQE TOTALE NDERTIMI M²
CMIMI I PARASHIKUAR PER M² (EURO)

43,100

500



MBI MBROJTJEN TERMIKE TE NDERTESAVE DHE SISTEMET E NGROHJES DHE UJIT TE NGROHTE SANITAR NE KONVIKTE

RRITJA E MBROJTJES TERMIKE ËSHTË DHE MBETET MËNYRA MË EFEKTIVE PËR TË NDËRTUAR DHE RIKONSTRUKTUAR NDËRTESAT ME NJË KONSUMIM SA ME TE ULET ENERGJETIK DHE PËR TË SIGURUAR KUSHTET KENAQSHME KOMFORTI TERMIK ME KOSTO OPERIMI TË ULET. KY KONKLuzion ËSHTË FUTUR NË RREGULLOREN E RE EUROPIANE PËR ENERGJINË, E CILA PRANON DHE VENDOS STANDARDE TË LARTA TË MBROJTJES TERMIKE, NË MËNYRË QË TË AVANCOJË ME MASA TË SOFISTIKUARA PËR KURSIMIN E ENERGJISË.

NE VENDIN TONË KA FILLUAR PREJ VITESH APLIKIMI I MBROJTJES TERMIKE TE NDERTESAVE, SI NE ATO TE REJA ASHTU EDHE NE EKZISTUESET. KY PROBLEM KA QENE EDHE NE VEMENDJEN E ORGANEVE SHTETERORE, DUKE U FINALIZUAR ME NJE LIGJ TE VECANTE , NR. 8937, DATË 12.09.2002 "PËR RUAJTJEN E NXEHTËSISË NË NDËRTESA" DHE TË VKM NR. 38 DATË 16.01.2003 "PËR MIRATIMIN E NORMAVE, TË RREGULLAVE DHE KUSHTEVE TË PROJEKTIMIT DHE TË NDËRTIMIT, TË PRODHIMIT DHE RUAJTJES SË NXEHTËSISË NË NDËRTESA".

TRIDHJETË VJET PAS VLERESIMIT NE THELLESI TE PRIORITETEVE TË TERMOIZOLIMIT, I CILI ËSHTË I DETYRUESHËM NË SHUMICËN E VENDEVE EUROPIANE, MATERIALET TERMOIZOLUESE JANË PËRSËRI MJETI KRYESOR PËR PËRMIRËSIMIN E EFIÇIENCËS SË ENERGJISË NË NDËRTESA. PËRDORIMI I MATERIALEVE TERMOIZOLUESE ËSHTË RRITUR, SI NË ASPEKTIN E KONCEPTIMIT TË EFEKTIVITETIT TË TERMOIZOLIMIT NË NDËRTESA, ASHTU EDHE NË ATË TË VLERAVE MINIMALE TË TIJ, TË PËRCAKTUARA NGA LEGJISLACIONI EKZISTUES.

MATERIALET TERMOIZOLUESE NUK JANË PRODHIM I PAVARUR ENERGJIE, OSE SISTEM RUAJTJEJE, POR PJESË E KOMPLEKSIT TË ELEMENTEVE STRUKTURORË, TË CILËT FORMOJNË SKELETIN E NJË NDËRTESE. NË KËTË KUPTIM, ATO NUK MUND TË VLERËSOHEN ME MËNYRËN E SISTEMIT PRODHUES TË ENERGJISË, SI SISTEMET TERMIKE DIELLORE OSE SISTEMET FOTOVOLTAIKE, POR ATO DUHET TË VLERËSOHEN SI PJESË INTEGRALE E

PROJEKTIMIT DHE E NDËRTIMIT TË NJË NDËRTESE.

GRUPET KRYESORE TË MATERIALEVE IZOLUESE JANE:

LESHI I XHAMIT (PËRBËHET PREJ RËRE KUARCË, DOLOMITEVE, GURIT GËLQEROR).

LESHI I GURIT (PËRBËHET NGA TË NJËJTËT MATERIALE BAZË SI DHE LESH I XHAMIT, POR ME TEMPERATURE SHKRIRJE TE LARTE TE KETYRE MATERIALEVE).

POLISTEROLI I BYMYER, PËRBËHET PREJ POLISTIRENI TË POLIMERIZUAR (1.5 – 2%) DHE AJËR (98–98.5%).

VESHJA TERMOIZOLUESE E NDERTESAVE SJELL MBROJTJEN E FASADAVE NGA AGJENTET ATMOSFERIKE DHE JEP KURSIME ENERGJITIKE TE MENJEHERESHME.

NGA PRAKTIKAT PERFUNDIMTARE TE FITUARA GJATE VITEVE, SISTEMI I IZOLIMIT TERMIK TE NDERTESAVE SJELL NJE REDUKTIM 25 % DERI 35 % TE KONSUMIT TE NEVOJSHËM ENEGJITIK PER NGROHJE.

MINISTRIA E ARSIMIT TE REPUBLIKES SE SHQIPERISE ESHTË ANGAZHUAR DISA VITE ME PARE NE PERGATITJEN E NJE STUDIMI UDHEZUES "PËR PËRMIRËSIMIN E STANDARTEVE TË SISTEMEVE TË RUAJTJES SË ENERGJISË, NGROHJES DHE VENTILIMIT NË OBJEKTET ARSIMORE", NE TE CILIN THEKSOHET:

"TERMOIZOLIMI I NDERTESAVE EKZISTUESE TE SHKOLLAVE, KOPSHTEVE DHE KONVIKTEVE REKOMANDOHET VETEM NE NDËRTESAT E PA RIKONSTRUKTUARA NE DREJTIM TE PERMIRËSIMIT TE STANDARTIT TERMIK TE NDERTESES ME QELIM ARRITJEN E STANDARTIT PER RRUAJTJEN E ENERGJISE NE KETO NDËRTESA. NDERHYRJA PER KETE QELIM DO TE REKOMANDOHET NE KETO ELEMENTE TE STRUKTURAVE RRETHUESE TE JASHTEME:

VESHJA E FASADAVE (MUREVE TE JASHTEME) ME MATERIAL IZOLUES POLISTEROL ME DENDESI 20KG/M³, TRASHESI 8 CM PER ZONEN E FTOHTE, 5 CM PER ZONEN ME KLIME



MESATARE DHE 3CM PER ZONEN BREGDETARE. KOEFICIENTI I PERCJELLSHMERISE PER KETE MATERIAL DO TE JETE TE PAKTEN ME I VOGEL SE $\lambda=0.040$ W/MK. PAS KESAJ SHITRESE FASADA MUND TE PLOTESOHET ME NGJITES DHE SUVA PLASTIKE KUNDER LAGESHTISE.

TARRACA PARA HIDROIZOLIMIT DUHET TE TERMOIZOLOHET ME NJE SHITRESE POLISTERINE ME TRASHESI 10 CM, ME NJE KOEFICIENT JO ME TE VOGEL SE $\lambda=0.050$ W/MK DHE DENDESI ME TE MADHE SE 15 KG/M³.

VENDOSJA E XHAMAVE DOPJO ME KASE DRURI OSE PLASTIKE. XHAMAT DUHET TE KENE MINIMALISHT NJE HAPASIRE AJRI MES TYRE DERI NE 10 MM DHE TRASHESINE JO ME TE VOGEL SE 4 MM. STANDARTI I SIGURISE NE RAST THYERJE DUHET TE PLOTESOHET ME KUSHTIN ARKITEKTONIK QE HAPESIRA DRITE E NJE XHAMI TE TILLE MOS TE KALOJE SIPERFAQEN 1 M². KJO GJE DUHET TE ELIMINOJE XHAMAT ME SIPERFAQE TE MADHE. KJO KONSIDERATE VLEN EDHE PER FASADAT E XHAMIT, PJESET E TE CILAVE NUK DUHET TE KALOJNE SIPERFAQE ME TE MADHE SE 1.5 M².

DRITARET DUHET TE JENE ME MBYLLJE ME LEVE DHE NE RASTE FARE TE RALLA TE RRESHQITSHME. KY REKOMANDIM BEHET PER TE ELIMINUAR INFILTRIMIN E AJRIT NE MASEN DERI 5 M³/ORE PER DRITARE. DRITARET REKOMANDOHEN ME PJESEN E SIPERME TE HAPSHME PJESERISHT NE MENYRE QE TE KRYHET VENTILIMI NATYRAL KUR NDERTESA NUK NGROHET.

DERA KRYESORE TE BEHET E TILLE, QE TE MOS KETE KONTAKT TE DREJTPERDREJTE ME MJEDISIN E JASHEM. REKOMANDOHEN DYER QE MBYLLEN ME FORCEN E SUSTAVE VETEMBYLLESE, OSE NE RASTIN KUR ARKITEKTURA LEJON- VENDOSJEN E DY PALE DYERVE. REKOMANDOHET NJE HAPASIRE E MBYLLUR, E CILA KUFIZON KONTAKTIN E AJRIT TE JASHEM ME AJRIN E NGROHUR.

GJITHASHTU, PER KONVIKTET :REKOMANDOHEN **SISTEME NGROHJE, QE DO TE MBULOJE NGARKESEN TERMIKE** TE LLOGARITUR SIPAS LIGJIT NR. 8937, DATË 12.09.2002 "PËR RUAJTJEN E NXEHTËSISË NË NDËRTESA" DHE TË VKM NR. 38 DATË 16.01.2003 "PËR

MIRATIMIN E NORMAVE, TË RREGULLAVE DHE KUSHTEVE TË PROJEKTIMIT DHE TË NDËRTIMIT, TË PRODHIMIT DHE RUAJTJES SË NXEHTËSISË NË NDËRTESA".

SISTEMET E NGROHJES QENDRORE DO TE FUNKSIONOJNE 24 ORE ME NGARKESE TE REDUKTUAR GJATE NATES NE MASEN 30% TE NGARKESES NOMINALE DITORE.

KY SISTEM DO TE PAJiset ME AUTOMATIKEN E DUHUR PER TE NDJEKUR NDRYSHIMET E TEMPERATURES SE JASHEME. SI TEMPERATURE E JASHEME LLOGARITESE PER IMPIANTIN E NGROHJES DO TE MERREN ATO TE REKOMANDUARA NGA INSTITUTI I HIDROMETEREOLOGJISE PER TEMPERATUREN MESATARE MINIMALE TE MUAJIT ME TE FTOHTE NE TRE VITET E FUNDIT. SI TEMPERATURE E BRENDSHME LLOGARITESE DO TE PRANOHET: PER ZONEN E PARE (TE FTOHTE) 18°C PER DHOMAT E NDEJES DHE 20°C PER BANJOT E DUSHET, PER ZONEN E DYTE (E ULTA) DHE TE TRETE (TE ULTA DHE BREGDETARE) 21°C PER DHOMAT E NDEJES DHE 22°C PER BANJOT E DUSHET.

APARATET NGROHES (RADIATORET) DUHET TE JENE PREJ ÇELIKU TE PETEZUAR OSE PREJ GIZE. NUK DO TE LEJOHEN NE TE ARDHMEN RADIATORE ALUMINI TE CILET JANE HEQUR NGA PERDORIMI NE BE PASI SHKAKTOJNE PROBLEME ME SHENDETIN. LIDHJA E RADIATOREVE ME TUBACIONET TE BEHET ME VENTILA KUNDER VANDALIZMIT TE CILET NUK DUHET TE PERDOREN NGA BANORET E KONVIKTEVE, PERVEÇ PERDORIMIT NGA PERSONA TE AUTORIZUAR. NUK LEJOHET LIDHJA E TUBACIONEVE ME RADIATORIN PA VENTIL KONTROLLI I CILI DUHET TE PERMBUSHE KUSHTIN QE PASI TE MBYLLET, TE LEJOJE HEQJEN E RADIATORIT DHE ZEVENDESIMIN E TIJ. MBESHETETJA E RADIATORIT NE MUR DUHET TE BEHET E TILLE QE TE PERBALLOJE PESHEN 100 KG MBESHETETJE MBI TE.

TUBACIONET QE LIDHIN APARATET NGROHES ME RADIATORET DO TE JENE PREJ ÇELIKU TE SALDUAR NE RASTIN KUR TUBI ESHTË MBI SIPERFAQEN E MURIT DHE/OSE PREJ MATERIALI PLASTIK ME VESHJE ALUMINI TE PETEZUAR DHE ME LIDHJE ME KOMPRESION NE RASTIN KUR TUBI I TERMOIZOLUAR ESHTË I VENDOSUR BREND MURIT.



GJENERATORI I NXEHTESISE (KALDAJA) DUHET TE PLOTESOJE TE KETE FUQINE E INSTALUAR 10% ME TE MADHE SE SASIA E NXEHTESISE E LLOGARITUR SIPAS NORMAVE TË MIRATUARA ME VKM NR. 38 DATË 16.01.2003.

PAJISJA E DJEGIES ME LENDE DJEGESE NAFTE SHTEPIAKE (SOLAR) DUHET TE PLOTESOJE KUSHTIN E DJEGIES SIPAS NORMES SE BE NE MASEN 95%. KJO DO TE VERTETOHET ME ANALIZAT E MBETJEVE TE CO₂ TE CILAT DUHET TE JENE BRENDA NORMAVE TE MIRATUARA MJEDISORE. REZERVA E LENDES DJEGESE DUHET TE LLOGARITET NE PROJEKT SIPAS KUSHTIT TE PAVARESISE SE SISTEMIT TE NGROHJES JO ME PAK SE 20 DITE KALENDARIKE.

SISTEMI I NGROHJES PER KONVIKTET NE TIRANË

NDERTESAT E KONVIKTEVE NE TIRANE NE QYTETIN „STUDENTI“, KANE NJE SISTEM QENDROR NGROHJE DHE UJI TE NGROHTE SANITAR, TE PROJEKTUAR DHE ZBATUAR RRETH 30 VITE ME PARE. SI LENDE DJEGESE ESHTË PERDORUR QYMYRI I GURIT.

RIAKTIVIZIMI I CENTRALIT QENDROR TE NGROHJES ESHTË NJE ZGJIDHJE ME RENTABEL NE KRAHASIM ME NGROHJET E VECUARA, PRA ME KALDAJA NE CDO NDERTESE KONVIKTI. NE KETE RAST, DUHET RIKONCEPTUAR IMPIANTI QENDROR ME KALDAJA TE REJA, QE DO TE PUNOJNE ME NAFTE, OSE GAS TE LENGET.

PERSA I PERKET PERGATITJES DHE SHPERNDARJES SE UJIT TE NGROHTE SANITAR, NEVOJITET NJE STUDIM I HOLLESISHEM TEKNIKO-EKONOMIK I RASTIT TE PERGATITJES QENDRORE TE KETIJ UJI, APO NE MENYRE LOKALE, NE CDO NDERTESE KONVIKTI.

PERGATITJA LOKALE TE JEP MUNDESINE E SHFRYTEZIMIT TE ENERGIJE DIELLORE PER NGROHJE UJI, MUNDESI QE NE NGROHJEN QENDRORE ESHTË SHUME E PAKET, PER ARESYE SE PANELET DIELLORE ZENE NJE SIPERFAQE TE KONSIDERUESHME. NE RASTIN E IMPIANTEVE LOKALE TE UJIT TE NGROHTE, TARACAT E KONVIKTEVE JANE TE MJAF TUESHME PER INSTALIMIN E PANELEVE DIELLORE.

SIGURISHT, SHFRYTEZIMI EFICIENT I ENERGIJE DIELLORE NDODH NE PERIUDHEN E NGROHTE TE VITIT, NDERSA NE STINEN E DIMRIT DO TE KERKOHET NJE ENERGI SHITESË PER NGROHJEN E UJIT SANITAR. KJO MUND TE JETE ENERGIJA ELEKTRIKE, E PERDORUR DIREKT ME REZISTENCA NE BOILERET E UJIT TE NGROHTE, OSE ME ANE TE POMPAVE TE NXEHTESISE AJER-UJE, QE KANE NJE KOEFICIENT TE SHFRYTEZIMIT TE ENERGIJE ELEKTRIKE ME ATE TERMIKE NE MASEN 1 ME 2, DERI 1 ME 3 (NE DIMER).

